



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 23.5.2023

Nr: 556

Ora: 15:00

VENDIM

PËR

**SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË
DELVINË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANEVE E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, nenit 162 dhe nenit 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VËREN:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, me vendimin nr. 113, datë 16.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Këshillin e Bashkisë Delvinë. Kundër vendimit të sipërcituar të KZAZ-së nuk rezulton të jetë bërë ankim brenda afateve ligjore.

Në bazë të nenit 162, pika 1, dhe 166, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përlllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Rezultati për subjektet zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Delvinë pasqyrohet në tabelën nr. 1 në vijim:

(Tabela nr.1)

Nr. FV	Subjekti Zgjedhor	Vota	Përqindja
1	Bashkë Fitojmë	804	16,47 %
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	2025	41,47 %
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	128	2,62 %

Data: 23.5.2023 Nr: 556
Ora: 15:00



“Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Delvinë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

4	Partia Republikane Shqiptare	95	1,95 %
5	Partia Lëvizja e Legalitetit	172	3,52 %
8	Partia Socialdemokrate	753	15,42 %
9	Partia Demokratike	416	8,52 %
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	245	5,02 %
13	Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë	245	5,02 %
	Totali	4883	100 %

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 15 (pesëmbëdhjetë) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Bashkia Delvinë, në bazë të shkresës nr.211/1 Prot, datë 27.02.2023, të Prefektit të Qarkut Vlorë.

Herësit e përfituar nga ky pjesëtim janë në tabelën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përftuar nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse, pra 15 (pesëmbëdhjetë). Nga kjo renditje marrim rezultatin e pasqyruar në tabelën nr.3, në vijim:

(Tabela nr.3)

Nr.	Herësi	Subjekti
1	2025	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	1012	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	804	Bashkë Fitojmë
4	753	Partia Socialdemokrate
5	675	Partia Socialiste e Shqipërisë
6	506	Partia Socialiste e Shqipërisë
7	416	Partia Demokratike
8	405	Partia Socialiste e Shqipërisë
9	402	Bashkë Fitojmë
10	376	Partia Socialdemokrate
11	337	Partia Socialiste e Shqipërisë
12	289	Partia Socialiste e Shqipërisë
13	268	Bashkë Fitojmë
14	253	Partia Socialiste e Shqipërisë
15	251	Partia Socialdemokrate

Në bazë të nenit 162, pika 5, të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar në tabelën nr. 3.

Nga kryerja e veprimeve të mësipërme marrim rezultatin për shpërndarjen e mandateve e pasqyruar në tabelën nr.4, në vijim:

(Tabela nr.4)

Nr.	Subjekti Zgjedhor	Mandate
1	Bashkë Fitojmë	3
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	8
3	Partia Socialdemokrate	3
4	Partia Demokratike	1

Sipas nenit 163, pika 1 dhe të nenit 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përllëgarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "i", e 2, nenin 162 dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOS:

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Delvinë, si më poshtë:

Subjekti Zgjedhor	Mandate
Bashkë Fitojmë	3
Partia Socialiste e Shqipërisë	8
Partia Socialdemokrate	3
Partia Demokratike	1

2. Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Delvinë, si më poshtë:

Bashkë Fitojmë

1. Anila Sami Kondi

Data: 23.5.2023 Nr: 556
Ora: 15:00



"Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Delvinë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

2.	Besnik	Shozo	Zero
3.	Eleni	Panajot	Papapano

Partia Socialiste e Shqipërisë

1.	Paola	Lulëzim	Boçi
2.	Fisnik	Bilal	Kohila
3.	Rozarta	Subhi	Gjikdhima
4.	Skerdian	Robert	Mehmeti
5.	Erinda	Bujar	Seitaj
6.	Petrit	Selman	Meleqi
7.	Suela	Miltjadh	Zoto
8.	Vasil	Pavlo	Marga

Partia Socialdemokrate

1.	Luan	Hysen	Selimi
2.	Lindita	Shuquri	Hamiti
3.	Orgest	Dashmir	Basho

Partia Demokratike

1.	Hari	Kristaq	Imeri
----	------	---------	-------

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Bashkia Delvinë, herësit

Tabela nr. 2

NR_FV	SUBJEKTI	SIGLA	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
1	Bashkë Fitojmë	BF	804	402	268	201	160	134	114	100	89	80	73	67	H e r ë s i t
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	2025	1012	675	506	405	337	289	253	225	202	184	168	
3	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë	P.A.A	128	64	42	32	25	21	18	16	14	12	11	10	
4	Partia Republikane Shqiptare	PR	95	47	31	23	19	15	13	11	10	9	8	7	
5	Partia Levizja e Legalitetit	PLL	172	86	57	43	34	28	24	21	19	17	15	14	
8	Partia Socialdemokrate	PSD	753	376	251	188	150	125	107	94	83	75	68	62	
9	Partia Demokratike	PDSH	416	208	138	104	83	69	59	52	46	41	37	34	
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	P.D.I.U	245	122	81	61	49	40	35	30	27	24	22	20	
13	Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë	PEISH	245	122	81	61	49	40	35	30	27	24	22	20	